



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.588/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Biometric Albania” shpk dhe mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” shpk nga procedura e prokurimit “ <i>Procedurë e Hapur</i> ” me REF-27550-06-19-2019 me objekt Loti II: “ <i>Qarkullimi ekstrakorporal</i> ”, fond limit 29.807.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.
Ankimues:	“Biometric Albania” shpk Rruga “Vllazën Huta”, Pallati i Ri “Vila Park”, 1/6/25 Tiranë
Autoriteti Kontraktor:	Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Rruga e Dibres Nr. 372, Tirane
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i

Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 19.06.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me REF-27550-06-19-2019 me objekt Loti II: “Qarkullimi ekstrakorporal”, fond limit 29.807.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.

II.2. Në datën 22.07.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 02.08.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoni si më poshtë vijon:

- Euromed	pa ofertë	I skualifikuar
- Gen-Alb Farma	pa ofertë	I skualifikuar
- Montal	pa ofertë	I skualifikuar
- OES Distrimed	pa ofertë	I skualifikuar
- Biometric Albania	29,795,000	I skualifikuar
- Fedos	29,807,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 02.08.2019 operatori ekonomik “Biometric Albania” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsye si më poshtë vijon:

- *OE nuk ploteson germen b) te pikes 2.8 KAPACITETI TEKNIK ne DST. Mostra e paraqitur nga OE per artikullin "Set autotransfuzioni i pershtatshem per aparatin Dideco" pas testimit ne Sherbimin e Kardiokirurgjise ka rezultuar se nuk eshte kompatibel me aparatin DIDEKO ekzistues. Ky set i ofruar nuk mund te pershtatet apo te modifikohet per aparatin ekzistues.*

II.5. Në datën 08.08.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Kontestojmë vendimin e KVO me argumentat e mëposhtëm:*

*Në DST e tenderit Lot qarkullimi ekstrakorporal është kërkuar: Artikulli 11 **Set autotransfuzioni i pershtatshem per aparatin Dideco / Cell saver set compatible for Dideco.***

Bazuar në specifikimet teknike të kërkuara OE Biometric Albania mbështetur nga firma prodhuese Dideco ka ofruar setin e autotransfuzionit i përshtatshëm për cdo aparat që vazhdon të prodhohet aktualisht nga firma Dideco sikurse është përcaktuar në DST. Në këto kushte OE Biometric Albania ka plotësuar 100% specifikimet teknike të kërkuara në DST të cilat janë i vetmi kusht i panegociueshëm për tu plotësuar nga OE në një procedurë tenderimi sikurse përcaktohet qartësisht në nenin 53 shqyrtimi i ofertave. Autoriteti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është

në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Mjafton argumenti i mësipërm për tu kualifikuar pa asnjë mëdyshje ofertën e OE Biometric Albania. Nga ana juaj si AK është mirëpërcaktuar: aparat Dideco për të cilin duhen setet e transfuzionit. Në të tilla kushte ne kemi ofruar ekzakt setet e transfuzionit për aparatit Dideco (duke plotësuar specifikimet teknike të kërkuara në DST) që kompania prodhuese Dideco prodhon:

Në arsyet e skualifikimit nuk është përcaktuar cili është lloji dhe aparati Dideco në të cilin juve e keni provuar mostrën tonë. Ka qenë detyrë e AK të përcaktojë qartë specifikimet teknike. Është detyrë e AK të përcaktojë qartazi modelin e aparatit Dideco që disponohet nga ana juaj në DST e tenderit. Mosparaqitja e modelit ka krijuar konfondim të ofertës së OE Biometric Albania shpk. Ne si operator ekonomikë nuk mendojmë se juve si AK keni në inventar pajisje të cilat kanë dalë nga qarkullimi i tregut dhe për të cilat nuk prodhohen me setet e transfuzionit nga kompania prodhuese Dideco/ose compatible të tyre, por në plotësim të specifikimeve teknike të kërkuara në DST kemi pas obligim të ofrojmë sete autotransfuzioni që përdoren në aparatet që prodhohen aktualisht nga firma prodhuese Dideco dhe për të cilat realizohet edhe mbështetja teknike e firmës prodhuese duke mos rrezikuar jetën e pacientëve.

Mospërcaktimi i modelit të aparatit Cell saver prodhim i firmës Dideco në DST ka bërë që OE mos të ankimohet për DST e tenderit, sikurse përcaktohet në nenin 63 të LPP, por ka proceduar në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST në mbështetje nga firma Dideco. Në të kundërt ngrihet dyshimi i arsyeshëm që mosvendosja e llojit dhe tipit të pajisjes është bërë me qëllim nga ana e AK, për të krijuar kushte për konkurrim të anshëm jo të barabartë dhe diskriminues të ofertuesve. Vendimi i KVO është në kundërshtim flagrant me nenin 55 i LPP pasi merr në shqyrtim ose i referohet modelit të aparatit që nuk i ka deklaruar në DST. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentat e tenderit. Me përgjegjësi deklarojmë se seti i ofruar nga OE Biometric Albania plotëson 100% specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe mostra e paraqitur nga an ajonë është pikërisht set transfuzioni për aparatit Dideco, tip pajisje në qarkullim , për të cilin sot prodhohen materiale konsumi nga prodhuesi Dideco. Për sa më sipër këkrojmë kualifikimin e ofertës së OE Biometric Albania.

Së dyti: Gjithashtu kundërshtojmë kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Fedos shpk. Në ditën e dorëzimit të mostrave OE Fedos shpk është paraqitur me set transfuzioni të kompanisë prodhuese Fresenius e cila nuk është set autotransfuzioni për aparatit Dideco për të cilin e keni kërkuar ju si AK në DST por duke deklaruar se së bashku me setet do sjellë në përdorim edhe një pajisje autotransfuzioni me prodhues Fresenius Kabi Gjermani. Theksojmë se OE Fedos

shpk ditën e paraqitjes së mostrave ka paraqitur vetëm mostrat dhe jo të shoqëruar me aparatën ku mund të kryhet verifikimi i mostrës. Pra mostra e paraqitur nga OE Fedos nuk është provuar nëse është kompatibël me sistemin e kërkuar apo ofruar (në kundërshtim flagrant të LPP dhe VKM), sikurse pretendohet se është vepruar me mostrën e paraqitur nga OE Biometric Albania.

Aparati i ofruar falas nga Fedos shpk nuk është paraqitur në ditën e dorëzimit të mostrës atherë si është kryer vlerësimi i mostrës nga ana e KVO??

Nga informacionet që disponojmë Fedos shpk nuk ka përmbushur kërkesën e përpuethshmërisë së seteve të ofruara me pajisjet objekt i kësaj procedure por ka propozuar pajisje ekstra jo Dideco në mënyrë që të funksionojnë me setet që ka ofruar prodhuar nga firma prodhuese Fresenius Kabi. Në asnjë pikë apo shtojcë të DST nuk përmendet që kërkohen apo mund të ofrohen pasjije alternative por kërkohet të ofrohet: **Set autotransfuzioni i pershtatshem per aparatën Dideco / Cell saver set compatible for Dideco.** Na rezulton se dhenia në përdorim e pajisjes/pajisjeve është një element që nuk është kërkuar nga AK në DT cka del jashtë objektit të përcaktuar nga vetë AK në DST.

Seti i ofruar nga OE Fedos shpk nuk është ekuivalent për tu përdorur me aparatën Dideco sikurse është kërkuar në DST por është një variant tjetër nga ai i kërkuar. Për sa më sipër në DST është kërkuar që do të blihen vetëm mallra (sete) që janë kompatibël me aparatën Dideco dhe që AK nuk do të pranojë variante. OE Fedos shpk nuk ka ofruar setet e kërkuara nga AK për aparatën Dideco por sete të tjera duke shtuar edhe dhënien në përdorim të pajisjes/pajisjeve shtesë të ndryshme nga prodhuesi Dideco dhe të pakërkua në DST. KVO nuk duhet të pranojë ofrimin e pajisjeve në përdorim nga OE Fedos shpk pasi kjo bie ndesh me nenin 51/2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: . Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohet që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.

AK ka përcaktuar si objekt prokurimi thjesht Blerje materiale mjekësore si dhe ka përcaktuar në DT vetëm pajisjet që ajo ka aktualisht në përdorim dhe për të cilat duhet të blihen material mjekimi dhe që të gjithë operatorët ekonomikë pjesmarrës duhet të ofrojnë materiale mjekësore dhe jo të ofrojnë aparate shtesë në përdorim.

Gjithashtu referuar vendimit të KPP 496/2019 juve si AK nuk keni zbatuar edhe rregullat e udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga neni 33 deri tek neni 41 si dhe pranimi i marrjes në përdorim i pasjive referuar si udhëzimeve të MSH ashtu edhe LPP duhet të bëhet nëpërmjet procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Fedos shpk oferta e të cilit përfshin ofrimin e SET autotransfuzioni së bashku me aparat shtesë për tu përdorur këto sete e ndryshme nga ajo e Dideco e përcaktuar në DST. Në kushtet kur objekti i prokurimit është blerje mallra propozimi i Fedos vjen në kundërshtim me përcaktimet e bëra në DST nga ana e AK si dhe shkakton diskriminim dhe konkurrencë të pandershme për OE e tjera pjesmarrëse.

Kërkojmë refuzimin e ofertës së OE Fedos shpk

Kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE Biometric Albania.

Bashkëlidhur vendimi KPP 496/2019.

II.6. Me shkresën nr.2885/4 prot datë 14.08.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Lidhur me pretenimin nr. 1: Me shkresën nr.2297/14 prot datë 01.08.2019 të Shërbimit të Kardiokirurgjisë drejtuar KVO në përgjigje të kërkesës për vlerësimin e mostrave të paraqitura për këtë Lot , Shërbimi i Kardiokirurgjisë pranë PAI Sëmundje e Brendshme citon se : Pasi vlerësuam mostrat e ardhura në shërbimin e kardiokirurgjisë dhe pas provës së bërë në lidhje me setin e autotransfuzionit rezulton që ky set nuk është kompatibël me aparatin Dideco ekzistues që ne disponojmë. Ky set i ofruar është kompatibël me një aparat tjetër Dideco të një modeli tjetër. Seti i ofruar nuk mund të përshtatet apo të modifikohet për aparatin ekzistues. Pra rezulton se artikulli me nr.11 i ofruar nga OE Biometric Albania nuk plotëson specifikimet teknike dhe nuk është kompatibël me aparatin Dideco që administrohet nga Shërbimi i Kardiokirurgjisë për të cilin kërkohen mallrat që prokurohen. Për sa i përket pretendimit të shtruar nga OE ankimues në lidhje me modelin e aparatit Dideco sqarojmë se OE Biometrik Albania ka pasur në dispozicion parashikimin e bërë nga legjislatori në momentin procedural të paraqitjes së ankesës sipas parashikimeve të nenit 63 pika 1/1 e LPP.*
- *Në lidhje me pretendimin nr.2 sqarojmë se në rastin e OE Fedos KVO nuk ka vlerësuar ofertën ekonomike duke u bazuar në ofrimin e aparaturave falas por vlerësimi i ofertës ekonomike rezulton të jetë bërë mbi bazën e përmbushjes së kriterëve të kërkuara në DST në lidhje me specifikimet teknike të mallrave që kërkohen të prokurohen.*
- *Nga korenspondenca e administruar nga KVO me shkresën nr.2297/11 prot datë 30.07.2019 “kthim përgjigje”, KVO në lidhje me parashikimet e Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në nëjsitë e sektorit publik”, është informuar se pajisje/aparati Dideco nuk është pjesë e inventarit/aseteve të shërbimit të kardiokirurgjisë. Duke u ndodhur në këto kushte për aq kohë sa*

pajisja Dideco e pasqyruar në DST nuk është aset i regjistruar i AK , KSHA vlerëson se AK gëzon të drejtën ligjore që të pranojë edhe pajisje në përdorim me kushtin logjik dhe ligjor që mallrat e ofruar nga operatorët ekonomikë ofertues të plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara nga Akdhe çështë më e rëndësishmja të përmbushin qëllimin e kërkuar nga AK duke respektur në të njëjtën kohë parashikimet ligjore të LPP dhe RRPP.

- *Në kontekst sa më sipër KSHA vlerëson se AK ka cdo të drejtë të mundshme të kualifikojë një operator ekonomik ofertues , në rastin kur mallrat e ofruar plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST , përmbushin qëllimin për të cilin është shpallur procedura e prokurimit si dhe OE ofertues përmbush të gjitha kriteret kualifikuese të hartuara sipas nenit 46 të LPP.*
- *Së dyti e gjithë gama e ankimit është e ndërtuar dhe referohet vetëm mbi bazën e informacionit që OE ankimues pretendon se disponon por në asnjë rast ankimit nuk i bashkëlidhet dokumentacioni teknik e ligjor që të vërtetojë ato që ankuesi referon apo të ndihmojë AK në thellimin e hetimit administrativ, pasi rezulton se mallrat e ofruar nga Fedos shpk i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga AK. OE ankimues në asnjë rast nuk ka sqaruar , argumentuar dhe më pas provuar me dokumentacion shtesë faktin e mosplotësimit të specifikimeve teknike.*
- *Të mos pranojë ankesën e OE Biometric Albania shpk.*

II.7. Në datën 23.08.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2885/8 prot datë 28.08.2019 protokolluar me tonën me nr.1426/2 prot datë 29.08.2019 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*OE nuk plotëson germen b) te pikes 2.8 KAPACITETI TEKNIK ne DST. Mostra e paraqitur nga OE per artikullin "Set*

autotransfuzioni i pershtatshem per aparatin Dideco" pas testimit ne Sherbimin e Kardiokirurgjise ka rezultuar se nuk eshte kompatibel me aparatin DIDECO ekzistues. Ky set i ofruar nuk mund te pershtatet apo te modifikohet per aparatin ekzistues", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Loti 2 Qarkullimi ekstrakorporal

Nr.	Emertimi	Njësia	Sasia e Pritshme	Shumatorja e çmimeve per njesi	Fondi limit / Vlera e pritshme e kontratave
1	Oksigjenator me fibra kapilare me fluks gjaku 0.5-7 l/min. Filtri arterial me siperfaqe jo me te madhe se 600 cm ² dhe pore me diameter jo me te medha se 40 µm. Volumi fillestar i mbushjes te jete me i vogel se 450 ml. Rezervuari venoz me kapacitet jo me pak se 4000 ml. Te jete i plotesuar me setin e tubave per pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe me tubat e kardioplegjise.	copë	970		
2	Oksigjenatori me fibra kapilare per neonate. Oksigjenatori te kete fluks gjaku maksimal 1.5l /min dhe volum fillestar <60 ml. Filtri arterial dhe diametri i poreve te filtrit jo me i madh se 40 µm. Rezervuari me volum fillestar mbushje <1100 ml. Sistemi te perfshije setin e tubave neonat per pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe te kardioplegjise	cope	45		

3	<p><i>Oksigjenatori me fibra kapilare per pediatrik bashke me rezervuarin venoz. Oksigjenatori te kete fluks gjaku maksimal 1-4 l/min dhe volum fillestar <145 ml. Filtri arterial dhe diametri i poreve te filtrit jo me i madh se 40µm. Rezervuari me volum fillestar mbushje <3000 ml. Sistemi te perfshije setin e tubave pediatrike per pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe te kardioplegjisë</i></p>	cope	45		
4	<p>Konektore plastike per tuba per QEK te drejte, permasa 1/2 x 1/2 <i>Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/2 x 1/2</i></p>	copë	700		
5	<p>Konektore plastike per tuba per QEK te drejte, permasa 1/2x3/8x3/8 me porte, luer lock <i>Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/2x3/8x3/8 ëith port luer locks</i></p>	copë	400		
6	<p>Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x3/8 me porte, luer lock <i>Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x3/8 ëith port luer lock</i></p>	copë	400		
7	<p>Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x1/4 me porte, luer lock <i>Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x1/4 ëith port luer lock</i></p>	copë	300		
8	<p>Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 1/4x1/4 me porte, luer lock <i>Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/4x1/4 ëith port luer locks</i></p>	copë	350		

9	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 1/4x1/4x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/4x1/4x1/4 ëith port luer locks	copë	350		
10	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x1/4x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x1/4x1/4 ëith port luer lock	copë	300		
1 1*	Set autotransfuzioni i pershtatshem per aparatin Dideco / Cell saver set compatible for Dideco	copë	40		
Vlera pa TVSH				71.620,00	29.807.000,00
TVSH				14.324,00	5.961.400,00
Vlera me TVSH				85.944,00	35.768.400,00

III.1.3. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si vijon:

b) Per te gjithë artikujt e ofertuar me shenjen asterisko (*) tek nr, duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 15.07.2019 ne oren 09:30. Dorezimi i kampioneve/ mostrave, te behet prane Drejtorise Juridike/Sektori Prokurimeve, QSUT "Nene Tereza", te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para datës _____.2019, ora ____ :_____.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçante, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

III.1.4. Në shtojcën 10 "Specifikimet teknike" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

LOT 2: QARKULLIMI EKSTRAKORPORAL

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikime të vecanta:

Loti 2 Qarkullimi ekstrakorporal		
Nr	Emertimi	Njesia
1	<i>Oksigjenator me fibra kapilare me fluks gjaku 0.5-7 l/min. Filtri arterial me sipërfaqe jo më të madhe se 600 cm² dhe pore me diametër jo më të mëdha se 40 µm. Volumi fillestar i mbushjes të jetës me i vogël se 450 ml. Rezervuari venoz me kapacitet jo më pak se 4000 ml. Të jetës i plotësuar me setin e tubave për pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe me tubat e kardioplegjisë.</i>	<i>copë</i>
2	<i>Oksigjenatori me fibra kapilare për neonatë. Oksigjenatori të ketë fluks gjaku maksimal 1.5l /min dhe volum fillestar <60 ml. Filtri arterial dhe diametri i poreve të filtrit jo më i madh se 40 µm. Rezervuari me volum fillestar mbushje <1100 ml. Sistemi të përfshijë setin e tubave neonat për pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe të kardioplegjisë</i>	<i>cope</i>
3	<i>Oksigjenatori me fibra kapilare për pediatrik bashkë me rezervuarin venoz. Oksigjenatori të ketë fluks gjaku maksimal 1-4 l/min dhe volum fillestar <145 ml. Filtri arterial dhe diametri i poreve të filtrit jo më i madh se 40µm. Rezervuari me volum fillestar mbushje <3000 ml. Sistemi të përfshijë setin e tubave pediatrike për pajisjen e qarkullimit ekstrakorporal si dhe të kardioplegjisë</i>	<i>cope</i>
4	Konektore plastike për tuba për QEK të drejta, permasa 1/2 x 1/2 <i>1/2 Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/2 x 1/2</i>	<i>copë</i>

5	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte, permasa 1/2x3/8x3/8 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/2x3/8x3/8 ëith port luer locks	copë
6	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x3/8 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x3/8 ëith port luer lock	copë
7	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x1/4 ëith port luer lock	copë
8	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 1/4x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/4x1/4 ëith port luer locks	copë
9	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 1/4x1/4x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 1/4x1/4x1/4 ëith port luer locks	copë
10	Konektore plastike per tuba per QEK te drejte permasa 3/8x1/4x1/4 me porte, luer lock Plastic connectors for ECC tubing straight type size 3/8x1/4x1/4 ëith port luer lock	copë
11*	Set autotransfuzioni i pershtatshem per aparatin Dideco / Cell saver set compatible for Dideco	copë

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se mostra e paraitur nga operatori ekonomik Biometric Albania shpk nuk është kompatibël me pajisjen që disponohet nga autoriteti kontraktor dhe nuk mund të përshtatet apo modifikohet me të. Ndërsa referuar parashtrimeve në ankesë ankimuesi pretendon se. *Ka qenë detyrë e AK të përcaktojë qartë specifikimet teknike. Është modelin e aparatit Dideco që disponohet nga ana juaj në DST e tenderit. Mosparaqitja e detyrë e AK të përcaktojë qartazi modelit ka krijuar konfondim të ofertës së OE Biometric Albania shpk. KPP gjykon se këto janë pretendime të cilat nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procedurës për arsye se afatet proceduriale për kundërshtimin e kritereve/specifikimeve teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit janë tejkaluar, në kuptim kjo të nenit 63 të LPP-së.*

Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret dhe specifikimet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose

mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vertetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera për operatorin e kualifikuar në procedurë, KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP,

ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*” me REF-27550-06-19-2019 me objekt Loti II: “*Qarkullimi ekstrakorporal*”, fond limit 29.807.000,00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 22.07.2019 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1426 Protokolli; Datë 23.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha